

MODUL TRAJNIMI

E DREJTA PER INFORMIMI

NË NIVELIN E VETËQEVERISJES VENDORE

TIRANË 2021



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

E DREJTA PËR NFORMIM

në nivelin e vetëqeverisjes vendore

Modul Trajnimi

Përgatitën modulin:

Armela Xhaho
Evelina Azizaj

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).



Norwegian Embassy



Tabela e lëndës

1. MBI MODULIN E TRAJNIMIT	4
1.1. Objektivat e modulit të trajnimit	4
1.2. Rezultatet e pritshme të modulit të trajnimit	4
1.3. Audiencia e trajnimit	4
1.4. Struktura e modulit të trajnimit	5
1.5. Metodologjia	5
2. RËNDËSIA E TË DREJTËS PËR INFORMIM	7
2.1 E drejta për informim	8
2.2 Pse është e rëndësishme e drejta për informim?	9
2.3 Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja qytetare	10
2.4 Sfidat dhe barrierat në lidhje me të drejtën e informimit	14
2.5 Roli i OSHC-ve në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin vendor	15
3. KUADRI RREGULLATOR I SË DREJTËS PËR INFORMIM	16
3.1. Kuadri normativ ndërkombëtar	17
3.2. Kuadri i brendshëm normativ	21
3.3. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”	24
4. INFORMIMI ME KËRKESË	26
4.1. Informimi me kërkesë	27
4.1.1 Si mund të bëjmë një kërkesë për informacion?	27
4.1.2 Mënyra e kërkimit të informacionit	27
4.1.3 A ka format të detyrueshëm dhënia e informacionit?	27
4.1.4 A ka detyrim për pagesë kundrejt informacionit që merr?	28
4.1.5 Çfarë do të konsiderohet tarifë?	28
4.1.6 Si veprohet me kërkesat për kërkim dokumentacioni?	28
4.1.7 Çfarë detyrimi ka autoriteti publik pas kërkesës?	28
4.1.8 Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	28
4.1.9 Afati për marrjen e informacionit	29
4.1.10 Koordinatorët për të drejtën e informimit	29
4.1.11 Çfarë mund të bëjmë nëse na refuzohet e drejta për informim?	30
4.1.12 Ankimimi	30
4.1.13 Çfarë vendos Komisioneri pas vlerësimit të ankesës suaj?	30
4.1.14 A ka penalizim për nëpunësit civilë, në rast mosrespektimi të së drejtës për informim?	30
4.2. Kur kufizohet e drejta për informim	32
5. INFORMIMI PA KËRKESË: Programi i Transparencës	33
5.1. Parime të përgjithshme të PT	34
5.2. Ku gjendet PT	35
5.3. Kategoritë e informacionit në Programin e Transparencës	35
5.4. Procesi i përgatitjes dhe zbatimit të programit të transparencës	37
6. SI INFORMOJNË BASHKITË NË SHQIPËRI	39
7. USHTRIME DHE RASTE STUDIMORE	42

Mbi modulën e trajnimit

1

1.1 Objektivat e modulit të trajnimit:

Ky modul ka për qëllim:

- 1** T'ju ofrojë OSHC-ve dhe aktorëve të interesuar njohuri të thelluara mbi konceptet kryesore teorike dhe kuadrin ligjor kombëtar e ndërkombëtar për të drejtën e informimit;
- 2** Të pajisë pjesëmarrësit me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin e të drejtës për informim në nivelin e vetëqeverisjes vendore;
- 3** T'ju ofrojë pjesëmarrësve udhëzime konkrete për modalitetet e marrjes së informacionit publik, procedurat për t'u informuar dhe për të bërë ankime, duke ofruar shembuj konkretë dhe duke prezantuar praktikën më të mira të informimit publik;
- 4** T'ju mundësojë pjesëmarrësve një qasje praktike për të analizuar dhe reflektuar mbi rëndësinë e transparencës në marrëdhëniet e qytetarëve me institucionet qeverisëse, rolin e rëndësishëm monitorues të OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë civilë në llogaridhënien, mirëqeverisjen dhe luftën kundër korrupsionit;
- 5** Të rrisë ndërgjegjësimin e OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë civilë në lidhje me rëndësinë e zbatimit dhe monitorimit të kësaj të drejte nëpërmjet instrumenteve ligjore, si për shembull Programi i Transparencës në nivel vendor.

1.2 Rezultatet e pritshme

Në përfundim të trajnimit pjesëmarrësit:

- Janë më të ndërgjegjësuar si qytetarë në ushtrimin e një prej të drejtave themelore të njeriut, siç është e drejta për informim;
- Mund të vënë në praktikë njohuritë e përftuara për të monitoruar në mënyrë objektive zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit;
- Kanë zgjeruar njohuritë për të analizuar dhe reflektuar mbi rastet e kufizimit të së drejtës për informim si dhe për hapat që mund të ndërmarrin për t'u informuar apo në rastet kur u mohohet kjo e drejtë;
- Kanë fituar aftësi praktike për të ndërmarrë nisma konkrete, që synojnë të nxisin llogaridhënien dhe transparencën e qeverisjes vendore.

1.3 Audiencia e trajnimit

- Audiencia kryesore e trajnimit:**
Përfaqësues të shoqërisë civile, OSHC vendore, aktivistë të përfshirë në nisma që nxisin qeverisjen e mirë vendore, luftën kundër korrupsionit, transparencën, etj.
- Aktorë të tjerë të interesi:**
Gazetarë, studiues, grupe të rinjsh dhe aktorë të tjerë kyç vendorë që janë të interesuar të promovojnë dhe monitorojnë zbatimin e të drejtës për informim në nivel vendor.

1.4 Struktura e modulit të trajnimit:

Kohëzgjatja: Moduli është hartuar për ofrimin e një trajnimi dyditor online.

Në pjesën të parë të trajnimit do të trajtohen konceptet kryesore që lidhen me të drejtën e informimit, me transparencën dhe llogaridhënien në nivelin vendor, duke u fokusuar edhe te rëndësia dhe niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Pjesa e dytë e trajnimit fokusohet në trajtimin e kuadrit rregullator për të drejtën e informimit. Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit do të njihen më nga afër me detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga zbatimi i ligji për të drejtën e informimit. Gjatë kësaj pjese të trajnimit dhe me qëllim ilustrimin me raste konkrete, trajnuesit do të prezantojnë disa nga instrumentet më efikase që përdoren nga bashkitë për të informuar publikun dhe grupet e interesit.

1.5 Metodologjia

Trajnimi do të zhvillohet online¹ përmes platformës së komunikimit ZOOM. Kjo platformë mundëson përdorimin e disa opsioneve dhe funksioneve, si komunikim me video, audio dhe me të shkruar [online chat], ndërveprim përmes tabelës së bardhë [whiteboard],² dhe ndarja e prezantimit, videove apo materialeve të tjera. Për të krijuar një dinamikë më të madhe të ndërveprimit në distancë, pjesëmarrësit do të ftohen vazhdimisht të jenë pjesë aktive e diskutimeve përmes pyetjeve-përgjigjeve dhe ndarjes së qëndrimeve apo përvojave vetjake që lidhen me ushtrimin e të drejtës për informim. Gjatë prezantimit të pjesës teorike, trajnuesit do të ofrojnë edhe shembuj praktikë nga realiteti me qëllim që të ilustrojnë në detaje koncepte të caktuara. Gjatë trajnimit do të përdoren disa metoda:

- ➔ Pjesëmarrësit do të ftohen të punojnë në mënyrë të pavarur me ushtrime të caktuara (shih ushtrimin 1 dhe 2) me qëllim vënien në zbatim të njohurive të përfuara. Përmes ushtrimeve, pjesëmarrësit do të kenë mundësi të mendojnë në mënyrë kritike jo vetëm për pjesën teorike, por edhe të analizojnë në mënyrë praktike probleme apo situata të caktuara, që kanë të bëjnë me detyrimet dhe kufizimet e të drejtës për informim. Kjo metodë synon të nxisë të menduarin kritik me qëllim reflektimin dhe përvetësimin e pjesës teorike.
- ➔ Trajnuesi do të ofrojë disa raste studimore konkrete apo skenarë imagjinarë, që janë realistë duke qenë se mund të ndeshen në praktikën e përditshme gjatë ushtrimit të së drejtës për informim. Për çdo rast studimor jepen disa pyetje për pjesëmarrësit, me qëllim që ata të praktikohen për zgjidhjen e problemeve sipas standardeve të kërkuara ligjore.
- ➔ Pjesëmarrësit do të kenë mundësi që të punojnë me ushtrime praktike dhe të diskutojnë në grupe për raste konkrete studimore, nëpërmjet të cilave synohet të zgjidhen problemet përmes diskutimit. Aplikacioni ZOOM ofron edhe mundësinë e punës në grupe të vogla me nga 4-5 pjesëmarrës (përmes dhomave të ndara). Pjesëmarrësit ndahen në mënyrë rastësore në disa grupe të vogla ku secili grup ka pothuajse të njëjtin numër pjesëmarrësish. Çdo grupi i jepet një temë e caktuar. Pjesëmarrësit diskutojnë më njëri-tjetrin temën e dhënë brenda një kohe të caktuar dhe japin zgjidhje të përbashkëta. Trajnuesi orienton dhe nxit çdo grup duke bërë pyetjeve. Secili grup cakton një anëtar për të prezantuar gjetjet e rena dakord si grup. Të gjithë pjesëmarrësit ftohen të mendojnë dhe të diskutojnë mbi gjetjet.

2.1 E drejta për informim

E drejta për informim nuk përbën vetëm një nga të drejtat themelore të njeriut, por është parakusht për qeverisje të hapur që garanton transparencë dhe llogaridhënie. Vetëm kohët e fundit e drejta për informim është njohur dhe afirmuar gjerësisht, por rrënjët dhe koncepti i saj datojnë që në shekullin e 18-të. Kjo e drejtë është garantuar për herë të parë në legjislacionin suedez, në Ligjin e Lirisë së Shtypit, të Mbretërisë Suedeze. Në këtë kontekst historik, vendet nordike njihen sot ndërkombëtarisht si pararendësit në çështjet e transparencës dhe të aksesit në informacion. Finlanda e ka miratuar një ligj të tillë në vitin 1961 dhe në vitin 1990 rreth 13 vende të ndryshme kishin miratuar legjislacion të tillë. Aktualisht janë rreth 120 vende që kanë njohur lirinë e informimit për veprimtarinë e organeve të qeverisjes.³ **E drejta për informim në Shqipëri garantohet ekskluzivisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.** Në përgjithësi, legjislacioni shqiptar në lidhje me të drejtën për informim rezulton të jetë i plotë dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

Një vështrim historik mbi garantimin e të drejtës së informimit




Figura. 1

³ https://www.transparency.org/news/feature/Right_to_information_knowledge_is_power

2.2 Pse është e rëndësishme e drejta për informim?

Informacioni etiketohet si oksigjen për demokracinë vendore, pasi krijon kushte për një qeverisje të hapur, transparente dhe të përgjegjshme. E drejta për informim fuqizon qytetarët për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për t'u bërë qytetarë më të përgjegjshëm.

Qëllimi i së drejtës për informim:⁴

- Garantimi i njohjes së publikut me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë;
- Garantimi i formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë;
- Nxitja e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.

E drejta për informim është:

- E drejta e qytetarëve për të pasur akses te dokumente zyrtare dhe detyrimi i institucioneve shtetërore për të përmbushur këtë të drejtë pa kërkuar motivet;
- Detyrimi i institucioneve publike për të ofruar disa kategori të dhënash edhe pa pasur nevojë për kërkesë të veçantë nga ana e publikut.

Informimi publik efektiv dhe në kohë nxit pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen vendore, duke zvogëluar kështu hendekun që ekziston mes institucioneve publike dhe qytetarëve. Duke pasur informacionin e duhur qytetarët bëhen të aftë për të kuptuar dhe vlerësuar vendimet që qeveria merr në emër të tyre. Qytetarët sigurohen që të taksat që paguajnë shpenzohen në interesin më të madh publik. Nga ana tjetër, aksesit tek informacioni publik krijon kushtet e përshtatshme që qytetarët që të jenë më të ndërgjegjësuar për rolin mbikëqyrës që kanë për qeverisjen. Njëkohësisht, me rritjen e ndërgjegjësimit qytetarët kanë më tepër mundësi për të ngritur zërin ndaj vendimmarrësve nëse kërkesat e tyre shpërfillen apo vendimet e zyrtarëve nuk janë në dobi të interesit publik. Qytetarët që janë më të informuar kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të administratës publike dhe, si rrjedhojë, janë në gjendje të paraqesin kërkesat apo ankesat e tyre pranë institucionit përkatës. Në këtë mënyrë, përmes shprehjes së këndvështrimeve dhe pikëpamjeve të tyre qytetarët ndihmojnë në përmirësimin e vendimmarrjes vendore të informuar, duke bërë të mundur që nevojat dhe kërkesat e tyre të merren në konsideratë nga autoritetet vendore.

Nga ana tjetër, informimi i publikut i bën zyrtarët vendorë më të përgjegjshëm për të marrë vendime të drejta në interes të publikut. Garantimi i të drejtës për informim forcon llogaridhënien dhe transparencën e qeverisjes, duke rritur besimin e publikut tek ajo. Një qeverisje e hapur është lehtësisht më e kontrollueshme nga qytetarët. Duke qenë të informuar në lidhje me aktivitetin e qeverisë, qytetarët e kanë më të lehtë të monitorojnë sjelljen e zyrtarëve vendor dhe ti vënë ata para përgjegjësive për veprimet që ndërmarrin në interes të publikut. Nga tjetër, rritja e etikës dhe llogaridhënies së zyrtarëve ndihmon në parandalimin apo uljen e mundësisë për abuzime me pushtetin përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Rrjedhimisht, zyrtarët e kanë më të vështirë të abuzojnë me pushtetin apo të përfshihen në akte korruptive.

⁴Neni 1 i Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

E drejta për informim është një proces shkëmbimi i dyanshëm ku institucionet publike dhe qytetarët komunikojnë në mënyrë të ndërsjellë.

E drejta e informimit përbën thelbin e zhvillimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Vlen të theksohet se respektimi i kësaj të drejte përbën një nga elementët kyç të mirëqeverisjes që duhet të garantohet për të gjithë qytetarët. Në këtë mënyrë, aksesit tek informacioni nxit pjesëmarrjen e informuar publike në vendime dhe kontribuon kështu në shmangien e korrupsionit, keq-qeverisjes duke inkurajuar një vendimmarrje më të përgjegjshme dhe të drejtë të institucioneve vendore. Pra, rritja e qëndrueshmërisë së luftës kundër korrupsionit dhe fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë vendore sigurohen përmes mekanizmave që garantojnë informimin dhe pjesëmarrjen në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OSHC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve vendore. Këto mekanizma përmirësojnë proceset demokratike, rrisin efikasitetin e shërbimeve dhe forcojnë besimin që qytetarët kanë te qeverisja.

2.3 Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja qytetare

Promovimi i qasjes në informacion dhe rritja e ndjeshmërisë qytetare në lidhje me të drejtën e informimit janë hapi i parë i rëndësishëm drejt transparencës, llogaridhënies dhe nxitjes së qytetarisë aktive në proceset vendimmarrëse.

Transparenca mund të përkufizohet si vënie në dispozicion të qytetarëve të informacioneve të prodhuara nga institucionet publike. Në kuptimin teorik, transparenca ka të bëjë me publikimin e informacionit procedural dhe përmbajtësor për shërbimet publike, në mënyrë të atillë që të jetë i aksesueshëm dhe gjerësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.⁵


Llogaridhënia publike siguron që zyrtarët të përgjigjen në mënyrë të hapur dhe të mbajnë përgjegjësi për vendimet që ata marrin në emër të publikut. Llogaridhënia ka të bëjë me përgjegjshmërinë e zyrtarëve publikë dhe të atyre që ndikojnë te këta të fundit në vendimmarrje, për veprimet e kryera në përputhje me procedurat ligjore. Nga ana tjetër, parimi i llogaridhënies në këndvështrimin institucional njihet edhe si “kontrollo dhe balanco”.⁶

- Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja qytetare janë procese të ndërlidhura me njëra tjetrën.
- Transparenca e institucioneve vendore është parakusht i domosdoshëm për një qeverisje të hapur dhe demokratike.
- E drejta e aksesit në informacion publik përmirëson transparencën dhe llogaridhënien në nivel vetëqeverisjeje vendore.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore, si autoritete publike, kanë detyrimin e garantimit të së drejtës për informim si detyrim kushtetues dhe ligjor për të siguruar transparencën e veprimtarisë së tyre.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime të rëndësishme të qeverisjes së mirë vendore. Të dy këto parime janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë. Kur një bashki është e hapur dhe transparente, qytetarët janë më aktivë dhe bëhen lehtësisht pjesë e proceseve vendore duke ndikuar në vendimmarrjen vendore nga e cila ndikohet jeta e tyre. Njëkohësisht, transparenca ecën paralelisht me integritetin dhe llogaridhënien e institucioneve vendore. Qasja e publikut tek informacioni është hapi i parë drejt transparencës dhe është baza për të rritur llogaridhënien e të zgjedhurve vendorë ndaj qytetarëve. Si rrjedhim, zyrtarët japin llogari për vendimet para komunitetit dhe grupeve të ndryshme në komunitete. Kjo, nga ana tjetër, rrit besimin e qytetarëve të qeverisja vendore duke ndikuar pozitivisht në legjitimitetin e qeverisjes vendore.⁷

Bashkitë, si niveli i qeverisjes më pranë qytetarëve dhe si ofrues të shërbimeve publike në nivel vendor, kanë një rol të rëndësishëm në informimin publik dhe vendimmarrjen vendore me pjesëmarrje.⁸

Figura 2: Rëndësia e të drejtës për informim në nivel vendor



Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është:

- një proces dinamik ku shqetësimet, nevojat dhe vlerat e qytetarëve përfshihen në vendimmarrje dhe qeverisje;
- komunikim dhe ndërveprim i dyanshëm mes qytetarëve dhe publikut, me qëllimin hartimin e politikave më të mira publike që promovojnë mirëqenien e qytetarëve dhe ulin varfërinë;
- jetike për një shoqëri demokratike.

(Agolli et al., 2013)⁹

⁷ Po aty

⁸ Po aty

⁹ Agolli, A., Guga, B. dhe Kapexhiu, E. (2013). Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile dhe Qytetarëve në Vendimmarrje. Një studim mbi kuadrin ligjor rregullator dhe praktikën në Shqipëri. Tiranë: Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Menaxhim Konfliktit.

OECD¹⁰ ofron një klasifikim më gjithëpërfshirës të pjesëmarrjes qytetare duke iu referuar natyrës dhe drejtimit të marrëdhënies mes qeverisë dhe qytetarëve si më poshtë:



Figura 3. Nivelet e bashkëpunimit mes qytetarëve dhe qeverisë

Burimi: OECD, 2001

1. Informimi është një marrëdhënie me një drejtim sipas së cilës qeveria vetëm prodhon dhe shpërndan informacione për qytetarët e saj. Informimi është niveli bazë ku hidhen themelet e bashkëpunimit mes institucioneve qeverisëse dhe qytetarëve. Ky bashkëpunim është i njëanshëm, pasi qeveria informon publikun për proceset dhe vendimet, ose qytetarët e kërkojnë informacionin përmes mekanizmeve ligjorë, si e drejta për qasje në dokumente publike, informacionet e publikuara në gazeta zyrtare ose në faqet e internetit. Informimi është parakusht për procesin e konsultimit.

2. Konsultimi është një marrëdhënie me dy drejtime në të cilën qytetarët mund t'i ofrojnë qeverisë 'opinionin' e tyre duke kontribuar me këndvështrimet dhe sugjerimet që kanë për çështje të caktuara. Shembuj për këtë janë konsultimet për legjislacionin, dokumentet strategjike, matja e qëndrimeve të publikut, etj. Konsultimi përbën një komunikim të kufizuar të dyanshëm mes qeverisë dhe qytetarëve.

3. Pjesëmarrja aktive është një marrëdhënie e bazuar te bashkëqeverisja. Angazhimi i qytetarëve në procesin e vendimmarrjes është formë e avancuar e komunikimit të dyanshëm mes qeverisë dhe qytetarëve. Pjesëmarrja aktive nënkupton se qytetarët angazhohen drejtpërdrejtë gjatë propozimit të politikave edhe pse jo domosdoshmërisht rekomandimet e tyre merren në konsideratë nga autoritetet publike.

Pra, pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje është me rëndësi të madhe jo vetëm për promovimin e transparencën, llogaridhënies dhe inkurajimin e qeverisjes së hapur, por është vendimtare edhe për krijimin e besimit të institucioneve vendore. Kjo lloj vendimmarrjeje e përbashkët institucion-qytetarë fuqizon këta të fundit dhe u jep atyre mundësinë të jenë pjesë e procesit të hartimit të politikave publike.

Pjesëmarrja e publikut në qeverisje lidhet ngushtë me hapjen dhe transparencën e institucioneve publike. Njëkohësisht, niveli i pjesëmarrjes së publikut në qeverinë lokale shpesh përdoret si indikator për të vlerësuar nivelin e demokracisë vendore. Në këtë këndvështrim, institucionet vendore duhet jo vetëm të ftojnë qytetarët për të marrë pjesë, por duhet ti sigurojnë atyre hapësira të mjaftueshme për të ndarë ide, për tu ankuar, diskutuar me ta çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së komuniteteve lokale.¹² Institucionet vendore duhet të sigurojnë mekanizma mundësues për një dialog të vazhdueshëm, duke i përfshirë qytetarët në proceset e vendimmarrëse.

Pse është e rëndësishme që qytetarët të informohen dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes vendore?

- Qytetarët janë më të vetëdijshëm për të kërkuar të drejtat e tyre
- Mundëson që qytetarët të kenë një rol mbikëqyrës ndaj institucioneve vendore
- Ndihmon në përmirësimin e politikave publike vendore
- Rrit besimin e qytetarëve te qeverisja vendore
- Qytetarët kanë mundësi të monitorojnë dhe vlerësojnë cilësinë e shërbimeve, me qëllim përmirësimin e këtyre shërbimeve
- Lehtëson marrjen e vendimeve dhe politikave publike të informuara, të cilat janë më efektive, plotësojnë nevojat reale dhe reflektojnë vlerat e komunitetit
- Angazhimi qytetar rrit shanset që komuniteti të pranojë politikat dhe vendimet e ndërmarra nga qeveria
- Ndikon në forcimin e demokracisë vendore dhe në minimizimin e praktikave korruptive
- Rrit interesin dhe angazhimin e qytetarëve në proceset vendimmarrëse duke kontribuar në nxitjen e qytetarisë aktive
- Promovon transparencën dhe llogaridhënien publike
- Ndihmon në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke fuqizuar qytetarët për të luftuar padrejtësitë dhe pabarazitë sociale

(Burimi: ATRC, 2012)¹¹

2.4 Sfidat dhe pengesat në lidhje më të drejtën e informimit:

Qendra për Ligj dhe Demokraci, e cila merret me renditjen e ligjeve për të drejtën e informimit në botë, e ka renditur Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit” në vendin e 6-të në botë përsa i përket parashikimeve të tij.¹³ Në këtë frymë, miratimi i ligjit për të drejtën e informimit është një hap i rëndësishëm për një qeverisje të hapur dhe gjithëpërfshirëse. Qytetarët tashmë kanë më tepër njohuri dhe duke qenë të informuar sigurisht ata do të jenë më pranë qeverisjes duke ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e tyre për pjesëmarrje në qeverisje. Megjithatë, për të siguruar një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse, nuk mjafton vetëm ekzistenca e ligjeve që sigurojnë akses të publikut tek informacioni.



Pavarësisht një kuadri të mirë ligjor, zbatimi i të drejtës për informim në nivel vendor ka ende sfida dhe vështirësi:

- Autoritetet vendore karakterizohen nga një qasje pasive e hapjes ndaj publikut, shpesh si pasojë e kulturës mbizotëruese të sekretit zyrtar, trashëguar nga periudha e komunizmit;
- Justifikimet e kufizimit të informacionit për shkak të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së cenimit të të dhënave personale dhe privatësisë¹⁴;
- Institucionet vendore nuk përdorin me efektivitet të gjitha instrumentet apo mekanizmat që mundësojnë përfshirjen aktive të qytetarëve në informimin publik¹⁵;
- Burokracia e institucioneve mund t'i dekurajojë qytetarët të kërkojnë informacion;
- Bashkitë kanë mangësi në burime njerëzore, kapacitete, kualifikime dhe trajnime të pamjaftueshme;¹⁶
- Bashkitë kanë njohuri të kufizuara në lidhje me të drejtën e informimit në nivel vendor;¹⁷
- Bashkitë nuk kanë arritur të garantojnë informimin publik të qytetarëve në zonat e largëta dhe shtresave e grupeve në nevojë (të varfërve, të papunëve, të personave me aftësi të kufizuara, të vetëpunësuarve në ekonomitë dhe në fermat familjare si dhe grupeve pakicë);¹⁸
- Nuk ka një sistem të unifikuar dhe të standardizuar për matjen e transparencës dhe të llogaridhënies nga ana e bashkive dhe aktorëve jo-publikë;¹⁹
- Qytetarët dhe veçanërisht grupet më të marginalizuara kanë njohuri më të kufizuara për ligjin për të drejtën e informimit dhe, për rrjedhojë, nuk e ushtrojnë siç duhet këtë të drejtë;²⁰
- Informacioni i bërë publik nga ana e bashkive mund të mos jetë i aksesueshëm apo i kuptueshëm për të gjitha subjektet e interesuara;
- Kultura apatike e qytetarëve për të qenë pjesë aktive e vendimmarrjes vendore;
- OSHC-të vendore kanë kapacitete të kufizuara për të monitoruar zbatimin e të drejtës për informim në nivel vendor. Si rrjedhojë, OSHC-të nuk kanë mekanizmat e duhur për të ushtruar presion më të madh për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies vendore.

13 Shih <https://www.law-democracy.org/live/rfi-rating/global/>

14 Matlija, D., Dule, D. (2019). E drejta e informimit 2019. Tiranë: Res Publica

15 IDM. (2018b). Situaata aktuale, sfidat dhe mundësitë për transparencë dhe llogaridhënie efektive në nivelin e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri.

16 Po aty

17 Po aty

18 Po aty

19 Po aty

20 Po aty

Me qëllimin për të adresuar sfidat kryesore të identifikuar në lidhje me informimin publik dhe garantimin e transparencës në nivelin e qeverisjes vendore, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar një Program model Transparence (PT) për qeverisjen vendore,²¹ i cili është i detyrueshëm për të 61 bashkitë e vendit. PT përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës në nivel vendor, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar ligjërisht ta zbatojë. PT synon t'i bëjë bashkitë proaktive në lidhje me ofrimin e informacionit publik.

Vlen të theksohet se pavarësisht progresit të bërë deri tani, monitorimet e kryera nga studime të ndryshme konstatojnë se duhet ende më shumë punë që këto programe transparence të jenë plotësisht funksionale dhe të plota sipas dispozitave ligjore.²² Po ashtu, nevojitet më shumë ndërgjegjësim dhe mekanizma për të lehtësuar aksesin në informacion të qytetarëve. **Ndryshimet ligjore duhet të shoqërohen me një ndryshim në mendësinë dhe kulturën e administratës publike dhe njëkohësisht me një ndërgjegjësim më të lartë të publikut.** Krijimi i një marrëdhënieje besimi mes publikut dhe autoriteteve është thelbi i ndryshimit kulturor. Rritja e besimit publik në qeverisje krijon më shumë gjasa për një komunikim më sistematik dhe një sinergji më të madhe mes të institucioneve dhe qytetarëve.

2.5 Roli i OSHC-ve në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin vendor

OSHC-të luajnë një rol kryesor në nxitjen e angazhimit qytetar dhe mbrojtjen e interesave të grupeve për të cilat punojnë apo që përfaqësojnë.²³ Edhe pse qytetarët mund të jenë të interesuar për të aksesuar informacionin publik, apo për të qenë pjesë e vendimmarrjes vendore, ata mund të mos kenë ndërgjegjësimin e duhur në lidhje me të drejtat e tyre. Rritja e qasjes qytetare në informacion është një hap i parë i rëndësishëm drejt fuqizimit të qytetarëve për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proceset vendimmarrëse. Përmes OSHC-ve qytetarët identifikojnë interesat e përbashkëta dhe, duke marrë shkas nga kjo gjë, ndërmarrin veprime kolektive në dobi të përmirësimit të cilësisë së jetës së tyre. Megjithatë, OSHC-të duhet të luajnë një rol më proaktiv për të mundësuar një lidhje më të drejtpërdrejtë dhe dinamike mes kërkesave të qytetarëve dhe llogaridhënies së autoriteteve në nivel vendor. Që ligji për të drejtën e informimit të prodhojë rezultate, qytetarët dhe veçanërisht shoqëria civile duhet të kenë informacion më të plotë dhe të konsoliduar në lidhje me këtë të drejtë.

Roli që OSHC-të kanë si mobilizues social midis komunitetit dhe institucioneve vendore është i një rëndësie tejet të madhe për angazhimin qytetar, për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike. Në këtë aspekt, OSHC-të mund të luajnë një shumë të rëndësishëm në promovimin dhe ndërgjegjësimin publik rreth ligjit për të drejtën e informimit dhe mënyrën se si qytetarët duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë.

Për sa më sipër, nevojitet një ndërgjegjësim dhe aftësim më i madh i shoqërisë civile, OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë të interesit për detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i të drejtës për informim dhe veçanërisht në përvetësimin e njohurive të duhura në lidhje me monitorimin e zbatimit të kësaj të drejte në nivel vendor.



21 Urdhër i Komisionit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Nr.211, datë 10.09.2018 "Për Miratimin e Programit Model të Transparence për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore".

22 Matlija, D., Dule, D. (2019). E drejta e informimit 2019. Tiranë: Res Publica

23 Agolli et al., 2013

3

3.1 KUADRI NORMATIV NDËRKOMBËTAR

Shqipëria ka aderuar në një sërë marrëveshesh, të cilat garantojnë të drejtën për informim si një e drejtë themelore e njeriut. Aktet kryesore të cilat sanksionojnë të drejtën për informim dhe ku Shqipëria bën pjesë, renditen më poshtë.

3.1.1 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)

E drejta themelore për akses të informacionit publik garantohet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Deklarata përbën një nga dokumentet themelore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ndër të cilat edhe të drejtën për informim. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në 10 dhjetor 1948.

Republika e Shqipërisë ka aderuar duke e bërë këtë deklaratë pjesë të së drejtës së brendshme dhe duke marrë përsipër angazhimin për përmbushjen e detyrimeve të saj në vitin 1955.

Neni 19: Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.

3.1.2 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (ECHR) u nënshkrua më 4 nëntor 1950, në Romë, Itali dhe hyri në fuqi më 3 shtator 1953. Republika e Shqipërisë e ka bërë pjesë të së drejtës së brendshme këtë konventë me anë të Ligjit Nr. 8137 datë 31.07.1996. “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut”. Konventa njeh lirinë për të marrë informacion pa pasur ndërhyrje nga autoritetet publike si një të drejtë themelore të njeriut, të cilën shtetet palë të Konventës duhet ta respektojnë.

Neni 10: Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë.

E drejta për lirinë e shprehjes nuk është një e drejtë absolute. Ushtrimi i këtyre të drejtave është përgjegjësi dhe çdokush është i detyruar t'i respektojë në mënyrën e duhur. Ato duhet të ushtrohen deri në limitet e përcaktuara nga konventa. Në të njëjtën kohë përpiqet edhe të mbrojë dinjitetin njerëzor kundër shpifjes apo shkeljeve të tjera të ngjashme.²⁴

Ndërhyrjet e caktuara në ushtrimin e kësaj të drejte arsyetohen sipas nenit 10, kështu që shtetet nënshkruese mund të imponojnë kufizime në këtë të drejtë në mënyrë legjitime.

3.1.3 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) është një traktat shumëpalësh i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 16 Dhjetor 1966 dhe hyri në fuqi me datë 23 Mars 1976. Pakti detyron palët e saj të respektojnë të drejtave civile dhe politike të individëve, duke përfshirë të drejtën për jetën, lirinë e fesë, lirinë e fjalës, lirinë e tubimit, të drejtat zgjedhore dhe të drejtat për një proces të rregullt dhe një gjykim të drejtë.

Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë traktat me anë të Ligjit Nr. 7510, datë 08.08.1991, “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”. Thelbi i këtij akti në lidhje me të drejtën e informimit shprehet në nenin 19, pika 2, ku thuhet se:

Neni 19

Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për hapur informata dhe ide të çdo lloji, pavarësisht nga kufijtë, në formën gojore, me shkrim, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.

3.1.4 Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore

Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore është traktati i parë ndërkombëtar detyrues që garanton të drejtat e komuniteteve dhe të autoriteteve të tyre të zgjedhura si dhe që përcakton parimin e subsidiaritetit sipas të cilit ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'i takojë më tepër autoriteteve që janë më pranë qytetarëve. Përmes nënshkrimit të Kartës Evropiane shtetet zotohen të respektojnë parimet bazë, mes të tjerash, të drejtën e qytetarëve që të marrin pjesë në administrimin e çështjeve publike.

3.1.5 Deklarata e KE-se për të Drejtën e Informimit 1982

Kjo deklaratë shpreh aksesin në informacion si një nga përparësitë në veprimtarinë e Këshillit të Evropës.

Neni 2 – E Drejta për akses në dokumente zyrtare

Secila Palë duhet të garantojë të drejtën e çdo personi, pa asnjë lloj diskriminimi, të ketë akses, sipas kërkesës, në dokumentet zyrtare që ruhen nga autoritetet publike.

Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare:

- Rekomandimi R (81) 19 mbi Aksesin tek Informacioni i Mbajtur nga Autoritetet Publike
- Rekomandimi nr. R (91) 10 mbi komunikimin tek të tretët të të dhënave personale që disponohen nga autoritetet publike
- Rekomandimi nr. R (97) 18 në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të mbledhura dhe të përpunuara për qëllime statistikore
- Rekomandimi nr. R (2000) 13 mbi politikën evropiane të aksesit në arkiva
- Rekomandimi (2002) 2 mbi Aksesin tek Dokumentet Zyrtare.

Parimi i përgjithshëm i dhënë në këtë rekomandim është se shtetet anëtare duhet të garantojnë të drejtën e të gjithëve për të pasur akses, sipas kërkesës, në dokumentet zyrtare që ruhen prej autoriteteve publike.

Rekomandimi (2002) 2 i bën thirrje shteteve anëtare të marrin masat e nevojshme që të informojnë publikun mbi këtë të drejtë, të trajtojnë zyrtarët publikë për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre si edhe të mundësojnë ushtrimin në praktikë të kësaj të drejte nga ana e qytetarëve.

3.1.6 Konventa për të Drejtën e Publikut për të Pasur Informacion (UNECE)

Kjo konventë u nënshkrua më 25 qershor 1998 në Aarhus, Danimarkë dhe hyri në fuqi më 30 tetor 2001. Kjo konvente është e njohur ndryshe si Konventa e Aarhusit.

Qëllimi i kësaj konvente është mbrojtja e të drejtës kolektive dhe interesit të çdo individi për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij. Për realizimin e këtij objekti, ajo detyron çdo palë që aderon në konventë të garantojë të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes, si dhe t'i drejtohet gjykatës për çështje të mjedisit, në përputhje me klauzolat e konventës.

3.1.7 Karta e Lirive Themelore të Bashkimit Evropian (Neni 42)

E miratuar në Samitin e Nisës në dhjetor 2000²⁵, kjo kartë përfshin ndër të tjera edhe nene për një qeverisje të hapur. Neni 10 i kësaj karte njeh dhe garanton të drejtën e shprehjes dhe informimit si një ndër të drejtat themelore në Bashkimin Evropian. Me Traktatin e Lisbonës, kjo kartë është bërë e detyrueshme për shtetet anëtare të BE-së.²⁶

25 Përcaktimi në këtë Kartë i të drejtës së mirëadministrimit (neni 41), të drejtës së aksesit në dokumentet zyrtare (neni 42), të Institutit të Avokatit të Popullit (neni 43), janë një zhvillim i ri dhe i konsiderueshëm në zhvillimin e të drejtave të njeriut, në gjirin e Komunitetit Evropian.

26 https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati_i_Lisbones_-_Verzioni_i_Konsoliduar.pdf

3.1.8 Kodi Evropian i Sjelljes Administrative të Mirë

I miratuar nga ana e Parlamentit Evropian në 6 shtator 2001 ky Kod ka për qëllim shpjegimin në detaj të Kartës Themelore të të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian dhe, më konkretisht, të së drejtës për miradministrim dhe asaj se çfarë kupton kjo e drejtë në praktikë. Një pjesë të rëndësishme të përcaktimeve të dhëna në këtë Kod zë trajtimi i së drejtës për informim si një e drejtë solidare me të drejtën e miradministrimit.

3.1.9 Konventa e Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso

E adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, më 27.11.2008, krijon detyrime informative edhe për subjekte si organet legjislative, autoritetet gjyqësore, apo edhe për personat fizikë apo juridikë, për aq kohë sa kryejnë funksione publike, apo kur operojnë me fonde publike, në përputhje me legjislacionin vendas.

3.1.10 Rezoluta dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës për Transparencën dhe Qeverisjen e Hapur

Rezoluta dhe rekomandimi u bëjnë thirrje autoriteteve vendore dhe rajonale për të rritur përdorimin dhe menaxhimin e të dhënave të hapura nga administrata e tyre dhe publikimin e tyre në mënyrë të atillë që këto të dhëna të kuptohen, të aksesohen dhe të përdoren lehtësisht.



3.2 KUADRI I BRENDSHËM NORMATIV

Legjislacioni shqiptar për të drejtën e informimit rezulton se reflekton në një masë të konsiderueshme standardet ndërkombëtare për ushtrimin e kësaj të drejte. Më poshtë do të trajtojmë kuadrin ligjor ku garantohej e drejta për informim në Shqipëri.

3.2.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Dokumenti më i rëndësishëm në kuptimin e akteve normative që afirmojnë dhe garantojnë të drejtën e informimit është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në nenin 23 të saj, përcaktohet se:

- E drejta e informimit është e garantuar.
- Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
- Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Ndërsa sanksionimin e parimit për një qeverisje të hapur dhe transparente e gjejmë në mënyrë indirekte në paragrafin e tretë të nenit 23 të Kushtetutës.

Si një e drejtë bazë për një qeverisje demokratike në nivel ndërkombëtar, e drejta për informim ka gjetur rregullim specifik që detajon kuptimin e saj në jetën e përditshme, në një grupim ligjesh të miratuara në respekt të hierarkisë dhe në harmoni me përmbajtjen e akteve më të larta normative, në vendin tonë.²⁷

3.2.2 Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”

Parimi i transparencës i sanksionuar në nenin 5 të Kodit të Procedurave Administrative i detyron organet publike që të bashkëpunojnë ngushtë me persona fizikë dhe juridikë.

Po ashtu, në Kodin i Procedurave Administrative në nenin 6 të tij sanksionohet parimi i informimit ku theksohet se: “Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit”. Kodi i Procedurave Administrative, në kreun II “E drejta për t’u informuar”, në nenet 51-55 përshkruhen detyrimet e administratës për informimin e qytetarëve, duke mbështetur parimin e një administrate të hapur dhe transparente.

Për herë të parë në Kodin e Procedurave Administrative është përcaktuar mënyra e funksionimit të zyrave me një ndalesë si një detyrim ligjor për ofrimin e shërbimeve sa më afër qytetarit dhe për të garantuar informimin e veprimtarisë së administratës publike dhe të procedurave administrative në shërbim të një qeverisje sa më transparente²⁸.

3.2.3 Ligji Nr. 139 /2014, “Për vetëqeverisjen vendore”

Një nga ligjet më të rëndësishme që rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë si dhe përcakton funksionet, kompetencat dhe të drejtat e tyre është ligji “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i cili ka hyrë në fuqi më 29 janar 2016. Si një e drejtë kushtetuese, e drejta për informim e qytetarëve në nivel vendor përcaktohet qartësisht në dispozitat e këtij ligji duke siguruar në këtë mënyrë transparencën në punën e organeve të qeverisjes vendore dhe mundësinë për publikun për të marrë pjesë aktive në qeverisje.

¹ Në kreun VI të titulluar “Transparenca, Konsultimi dhe Pjesëmarrja Qytetare” ligji i kushton rëndësi dhe hapësirë të veçantë garantimit të së drejtës së informimit të qytetarëve dhe pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë e drejta e publikut për informim dhe parimi i transparencës, sanksionohen në pikën 1 dhe 2 të nenit 15 të ligjit, ku përcaktohet se:

¹ Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.

² Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.

Po ashtu në pikën 3, të nenit 15, në ligj është përcaktuar se:

“Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit”

Gjithashtu në nenin 18 të po këtij ligji është parashikuar që aktet e këshillit bashkiak publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli për këtë qëllim.

Neni 19 i Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” sanksionon për publikun të drejtën e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes. Nga ky parashikim çdo qytetari dhe grupi që përfaqëson komunitetet iu lind e drejta t’ju drejtojnë kërkesa, ankesa dhe vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksionet dhe kompetencat nën juridiksionin e qeverisjes vendore.

3.2.4 Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Ligji Nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.

Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ligji përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.

Për të garantuar një proces konsultimi publik sa më gjithëpërfshirës dhe për të garantuar pjesëmarrjen e publikut në qeverisje, ligji detyron organet e autoritetit publik të kryejnë një proces sa më transparent. Ato duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të informuar nëpërmjet publikimeve në regjistrin elektronik të projekt-aktit, si dhe në programin e transparencës, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes. Ato duhet të informojnë në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit e deri te miratimi i aktit përfundimtar. Gjatë këtij procesi, ato duhet të ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të krijuar mundësinë efektive të kontributit, për të gjitha palët e interesuara. Zbatimi i këtij ligji kontribuon drejtpërsëdrejti në nivelin e llogaridhënies së zyrtarëve publik në nivel vendor.

3.2.5 Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020

Miraturar në korrik të vitit 2015, strategjia paraqet vizionin e qeverisë për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore nëpërmjet (i) përmirësimit të efikasitetit të strukturave të qeverisjes vendore, (ii) forcimit

të kapaciteteve fiskale vendore (iii) nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm vendor dhe (iv) thellimit të qeverisjes së mirë dhe demokracisë vendore nëpërmjet pjesëmarrjes, angazhimit qytetar dhe krijimit të strukturave komunitare për dialog dhe konsultim në vendimmarrje. Strategjia citon se: “Parimet e qeverisjes së hapur, transparencës dhe llogaridhënies do të jenë parime të detyruara për tu aplikuar nga njësitë e qeverisjes vendore me ndryshimet që do i bëhen ligjit të ri organik të qeverisjes vendore”.

3.3 Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Një nga ligjet më kryesore në legjislacionin shqiptar që garanton të drejtën e informimit në lidhje me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritet publike është Ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, miratuar më 18.09.2014. Me miratimin e këtij ligji është shfuqizuar ligji i mëparshëm Nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për Dokumentet Zyrtare”, i cili rregullonte të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare.

Ligji synon garantimin e njohjes së publikut me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë. Dispozitat e këtij ligji kanë për qëllim nxitjen e integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.²⁹

3.3.1 Parimet e përgjithshme të së drejtës për informim shtjellohet në ligj si vijon:

- ✓ Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
- ✓ Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin, nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
- ✓ Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
- ✓ Informacioni publik që i është dhënë një personi nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit.³⁰

3.3.2 Çfarë përfshihet në “Informacionin publik”?³¹

Sipas nenit 2 të ligjit, “Informacioni publik” përfshin çdo të dhënë të regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Kjo nënkupton se autoritetet janë të detyruara të japin akses në dokumentet që disponojnë në arkivat apo dosjet e tyre të punës, qofshin këto dokumente shkresorë ose audiovizualë, apo çdo lloj tjetër. Dokumentet mund të ndahen në tre kategori:

3.3.1 Parimet e së drejtës për informim?

²⁹ Shih: neni 1, Ligji Nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”,

³⁰ Po aty neni 3.

³¹ Po aty, neni 2, pika 2

- Dokumente të krijuara nga vetë autoriteti
- Dokumente të ardhura prej një autoriteti tjetër
- Dokumente të ardhura prej subjekteve private

3.3.3 Kush ka të drejtë të kërkojë informacionin/dokumentin? (neni 2, pika 3)

Si çdo e drejtë e njeriut, e drejta për informimin u përket të gjithëve. Neni 2 i ligjit ka përcaktuar se kërkues mund të jetë çdo person, fizik apo juridik, vendas apo i huaj, apo edhe pa shtetësi.

3.3.4 Autoritetet e detyruara për të dhënë informacion:

Ligji për të Drejtën e Informimit përcakton:

- Organet administrative të parashikuara në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj;
- Shoqëritë tregtare, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve dhe ku ushtrohen funksione publike;
- Çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor, ose çdo lloj formë tjetër, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.³²

4

INFORMIMI ME KËRKESË

4.1 Informimi me kërkesë

E drejta e qytetarëve të kërkojnë informacion pa shpjeguar motivet e kërkesës dhe detyrimi i institucioneve publike për të përmbushur këtë të drejtë duke respektuar kufizimet e të drejtës së informimit.³³

4.1.1 Si mund të bëjmë një kërkesë për informacion?³⁴

1. Kliko faqen zyrtare të bashkisë dhe verifiko nëse informacioni që kërkon nuk është i shpallur në faqen e internetit apo në Programin e Transparencës (shpjeguar si më poshtë).
2. Nëse informacioni nuk është në PT, gjeni të dhënat e koordinitorit për të drejtën e informimit në faqen e internetit të institucionit.
3. Shkarkoni formularin e kërkesës për informacion në faqen e internetit të institucionit dhe i bëni një kërkesë me shkrim koordinitorit për të drejtën e informimit.

4.1.2 Mënyra e kërkimit të informacionit³⁵

Kërkesa për informim mund të bëhet në tre mënyra:

- me shkrim dhe dërgohet dorazi - duke ruajtur numrin e protokollit;
- me postë - ruaj kuponin postar;
- ose me postë elektronike- ruaj e-mailin e dërguar me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij.

4.1.3 A ka format të detyrueshëm dhënia e informacionit?

Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare në Internet të autoritetit publik.³⁶

Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.³⁷

³³ Po aty, neni 3

³⁴ Shih <https://portavendore.al/hymebashki/e-drejta-e-informimit/>

³⁵ Po aty, neni 11.

³⁶ Po aty, neni 14/1.

³⁷ Po aty, neni 9.

4.1.4 A ka detyrim për pagesë kundrejt informacionit që merr?

Dhënia e informacionit është pa pagesë. Por, ky shërbim i administratës publike mund të ofrohet edhe kundrejt një tarife, sipas disa kriterëve:

- (i) të jetë e përcaktuar më parë;
- (ii) të jetë e bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut.³⁸

4.1.5 Çfarë do të konsiderohet tarifë?

- Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe kur është rasti, e dërgimit të tij.
- Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas.
- Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni.
- Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg.³⁹

4.1.6 Si veprohet me kërkesat për kërkim dokumentacioni?

Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:

- a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta;
- b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.⁴⁰

4.1.7 Çfarë detyrimi ka autoriteti publik pas kërkesës?⁴¹

- Sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit, autoriteti publik që merr një kërkesë është i detyruar të informojë kërkuarin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

4.1.8 Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve⁴²

Sipas nenit 8 të ligjit, autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjister të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjister përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik si dhe në mjediset e pritjes së publikut e në mjediset e autoritetit publik.

Ky mjet pritet që të jetë shumë efektiv në lidhje me informimin mbi

³⁸ Po aty, neni 13.

³⁹ Po aty, neni 13, prg.1 dhe prg.2.

⁴⁰ Neni 14/2 i Ligjit për të Drejtën e Informimit.

⁴¹ Në lidhje me detyrimet që i rrjedhin autoritetit publik nga Ligji për të Drejtën e Informimit, mund t'i referoheni website të KDIMDP online:

<http://idp.al/index.php/sq/per-autoritetin-publik/241-detyrimet>

⁴² Po aty, neni 8.

ecurinë e një kërkesë për informim, pasi:

1. Duke aksesuar këtë regjistër online, çdo person që është i interesuar për një informacion ka gjasë që të gjejë informacionin nëse një person tjetër e ka kërkuar më parë dhe nëse përgjigja tashmë është online;
2. Kërkuesi mund të njihet me ecurinë e kërkesës së tij në kohë reale;
3. Një kërkues, i cili ka marrë një herë përgjigje dhe për arsye të ndryshme mund ta ketë humbur dokumentin, mund të shkarkojë online përsëri një kopje tjetër.

4.1.9 Afati për marrjen e informacionit⁴³

Në ndryshim me ligjin e mëparshëm, ku afati për të dhënë informacion sipas kërkesës ishte 40 ditë, afatet e kthimit të përgjigjeve mbi kërkesën për informim, sipas ligjit të ri, janë për sa vijon:

- jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës, autoriteti publik duhet ta trajtojë, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur;
- jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë, kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër;
- të dyja këto afate mund të zgjaten me jo më shumë se 5 ditë pune, për një nga shkaqet e mëposhtme:
 - nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;
 - nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;
 - nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim nga nëpunësi civil brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.

4.1.10 Koordinatorët për të drejtën e informimit⁴⁴

Koordinatorit për të drejtën e informimit është një nëpunës, i cili ka si detyrë të bashkërendoj punën për garantimin e së drejtës së informimit.⁴⁵

Sipas nenit 10 të Ligjit për të Drejtën e Informimit, në çdo autoritet publik, titullari cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Ata janë përgjegjës për dhënien e informacionit, dhe do të përballen me sanksione administrative nëse informacioni do të refuzohet në kundërshtim me ligjin dhe në tejkalim të afateve të përcaktuara në ligj.

4.1.11 Çfarë mund të bëjmë nëse na refuzohet e drejta për informim?

Çdo person, kur vlerëson se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Komisioneri). Ankimi bëhet në rastet kur bashkia:

43 Po aty, neni 15

44 Po aty, neni 2, pika 6

45 Po aty: neni 10

- Refuzon dhënien e informacionit/ nuk përgjigjet
- Kthen përgjigje pa vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar
- Kthen përgjigje të paplotë

Shkarkoni formatin e ankesës në faqen e internetit të institucionit, bëni një ankesë me shkrim dhe dërgojeni pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me: a) e-mail; b) dorazi; c) postë.⁴⁶

4.1.12 Ankimimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve nga:⁴⁷

- ➔ Data kur ankuesi ka marrë njoftimin për refuzimin e informacionit;
- ➔ Data e kalimit të afatit për dhënien e informacionit të parashikuar në ligjin për të drejtë e informimit;
- ➔ Komisioneri merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita e dorëzimit të ankesës;
- ➔ Mosrespektimi i dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit, sjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në nenin 18 të ligjit për të drejtë e informimit.

4.1.13. Çfarë vendos Komisioneri pas vlerësimit të ankesës suaj?⁴⁸

- a) Pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme brenda një afati të caktuar. Në rast se autoriteti nuk jep sërish informacion, Komisioneri ka të drejtë të përcaktojë përgjegjësinë direkte dhe gjobën për titullarin e autoritetit publik, koordinatorin e të drejtës së informimit, apo çdo nëpunës të autoritetit, i cili ka penguar plotësimin e kërkesës tuaj.
- b. Mospranimin e kërkesës kur: i) ka kaluar afati i caktuar ligjor për paraqitjen e ankesës; ii) ankimi nuk paraqitet në formë shkresore ose me e-mail; iii) nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit.
- c. Rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht.

4.1.14 A ka penalizim për nëpunësit civilë në rast mosrespektimi të së drejtës për informim?

Mosrespektimi i dispozitave të Ligjit për të Drejtën e Informimit sjell përgjegjësi administrative për titullarin e institucionit, koordinatorin për të drejtën e informimit. Veprimet dhe mosveprimet sipas ligjit, për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.⁴⁹

4.1.15 Çdo nëpunës i autoritetit publik ka përgjegjësi administrative në lidhje me:

- dëmtimin ose shkatërrimin e dokumenteve zyrtare, me qëllim shmangien e së drejtës për informim;

46 Shih https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/03/E_drejta_per_informim-Procedura_e_ankimit.pdf

47 Po aty, neni 24/2

48 Po aty, neni 24/5.

49 Po aty, neni 18.

- moszbardhjen e dokumenteve zyrtare në kundërshtim me rregullat në fuqi, me qëllim; pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim.⁵⁰

4.1.16 Koordinatori për të drejtën e informimit mban përgjegjësi për rastet e mëposhtme:⁵¹

- Refuzimin e dhënies së informacionit;
- Moskrijimin, mosmbajtjen, mospublikimin apo përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve që duhet krijuar në çdo institucion;
- Mosplotësimin e kërkesave për informacione të regjistruara brenda afatit dhe sipas mënyrës së parashikuar me ligj;
- Mosregjistrimin e kërkesës për informim, moscaktimin e një numri rendor për të si dhe mosdhënien e të dhënave të kontaktit të Koordinatorit;
- Mosdërgimin e kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik;
- Dërgimin e kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik, kur autoriteti që e ka dërguar e ka informacionin;
- Mosnjoftimin e kërkuesit se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër publik;
- Mosrespektimin e kërkesave për dhënien falas të informacionit;
- Refuzimin e paarsyetuar të preferencës së kërkuesit për mënyrën e dhënies së informacionit;
- Mosnjoftimin e kërkuesit për vendimin për zgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesës;
- Moskryerjen e njoftimeve paraprake mbi koston e lartë të kërkesës, ose për nevojën për më shumë kohë për trajtimin e saj.

4.1.17 Përgjegjësitë ligjore - administrative të titullarëve, janë për sa vijon:

- Mosvënien në zbatim të programit institucional të transparencës;
- Mosrishikimin e programit institucional të transparencës, brenda afatit;
- Mosndjekjen e procedurave për rishikimin e programit institucional të transparencës;
- Mosrespektimin e kërkesave për dhënien falas të informacionit, për qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore si dhe subjektet përfituese sipas Ligjit Nr. 10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”.⁵²

Nëpunësit më të lartë civilë (Sekretar i Përgjithshëm, Drejtori Departamenti ose Drejtor Drejtorie të Përgjithshme të institucioneve, ose pozicione të barasvlershëm me to), mbajnë përgjegjësi për të gjitha kompetencat, që titullarët mund t’ia delegojnë sipas ligjit, në lidhje me respektimin e kërkesave të të drejtës për informim, për sa vijon:

- Mosvënien në zbatim të programit institucional të transparencës;
- Mosrishikimin e programit institucional të transparencës, brenda afatit;
- Mosndjekjen e procedurave për rishikimin e programit institucional të transparencës;
- Mospërcaktimin paraprakisht të një tarife, mospublikimi, ose caktimi i tarifave abuzive për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit.

(Neni 19/2)

⁵⁰ Po aty, neni 19/4.

⁵¹ Po aty, neni 10.

⁵² Po aty, neni 13/4.

4.2 Kur kufizohet e drejta për informim?

Ashtu siç edhe parashikohet edhe nga aktet ndërkombëtare të përshkruara në këtë kapitull, edhe ky ligj ka parashikuar rastet për të cilat e drejta për informim mund të kufizohet.

Rastet e kufizimit të kërkesës për informacion: ⁵³

Ligji për të Drejtën e Informimit parashikon se e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

- a) të drejtën për një jetë private;
- b) sekretin tregtar;
- c) të drejtën e autorit;
- ç) patentat.



Po kështu e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:

- a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
- b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
- c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;
- ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;
- d) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;
- dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;
- e) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;
- ë) mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare.⁵⁴

Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilit argument ligjor është bërë refuzimi. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

⁵³ Po aty, neni 17

⁵⁴ Po aty, neni 17.

-
- 5. Informimi pa kërkesë
-
- Programi i Transparencës

5

INFORMIMI PA KËRKESË

Programi i Transparencës

Informimi pa kërkesë realizohet nëpërmjet Programit të Transparencës (PT), i cili përkufizohet si tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik. Bashkia, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet Programit të Transparencës (PT) synon t'u garantojë qytetarëve të vet të drejtën e lirisë së shprehjes për çështjet vendore. Me anë të Programit të Transparencës, autoritetet vendore duhet të marrin në konsideratë interesin më të lartë të komunitetit, veçanërisht për të siguruar akses maksimal në informacionin në dispozicion të publikut, dhe të bëjnë publik sa më shumë informacion që të jetë e mundur, në mënyrë që të zvogëlohet nevoja për kërkesa individuale për informacion.

5.1 Parime të përgjithshme të PT⁵⁵

Për garantimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit, bashkia në hartimin e Programit të Transparencës është bazuar në parimin e:

- a. Vendosi në dispozicion të çdo qytetari të bashkisë, por jo vetëm, të gjithë informacionin e prodhuar nga veprimtaria e saj (nga organet e saj, administrata, njësitë administrative dhe njësitë e varësisë). Përjashtim nga ky parim bën pjesë vetëm informacioni që kufizohet nga ligjimi (Neni 17 ligji 119/2014).
- b. Ligjshmërisë, transparencës dhe të mosdiskriminimit. Informimi i qytetarëve bëhet në përputhje me të gjithë kuadrin e sotëm ligjor, duke i dhënë përparësi Ligjit për të Drejtën e Informimit. Për sa i përket procesit të informimit, bashkia e ushtron në mënyrë të hapur, transparente dhe shmang çdo lloj diskriminimi.
- c. Ofrimit të informacionit pa pagesë. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike i jepet çdo qytetari pa pagesë. Çdo qytetar përfiton informacion pa pagesë deri në ...faqe, mbi këtë numër faqesh qytetari paguan një tarifë shërbimi prej ...lekësh.
- d. Aksesit për këdo. Aksesit për shtresat më të varfra të komunitetit, qytetarët me aftësi të kufizuara, gratë, të rinjtë, biznesin, fermerët, qytetarët e zonave të largëta etj. merr përparësi.
- e. Thjeshtëzimit të procedurave administrative për aksesin në informacion. Procedurat për informim do të jenë vazhdimisht në një proces thjeshtëzimi dhe qartësimi me qëllim që ato të jenë lehtësisht të përdorshme nga qytetarët.
- f. Dhënies së informacionit sa më shpejtë që të jetë e mundur. Informacioni do të jepet kurdoherë brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- g. Cilësisë së informacionit. Çdo informacion në dispozicion të qytetarëve do të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;

- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të bashkisë;
- lehtësisht i përdorshëm.

5.2 Ku gjendet PT?

- **Online:** PT publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” .
- **I printuar:** PT vendoset në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë, njërive administrative dhe njërive të varësisë.

5.3 Kategoritë e Informacionit në Programin e Transparencës⁵⁶

Për të rritur aksesin në informacion në nivel vendor, veçanërisht për komunitetet më të varfra, autoritetet vendore duhet të hartojnë dhe të përditësojnë Programin e Transparencës, i cili duhet të përgatitet sipas formatit standard të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.⁵⁷

Për t'i bërë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm të 16 kategoritë e informacionit, të parashikuar shprehimisht në nenin 7 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, janë përshtatur me kontekstin e vetëqeverisjes vendore, me misionin, detyrat, funksionet dhe kompetencat e bashkisë. Në këtë kuadër, tabela përmbledhëse e Programit të Transparencës ndahet në 7 fusha kryesore:

- ➔ Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë është fusha e parë e programit dhe përfshin kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë të përcaktuar nga neni 7 (pika: a; d; g; ç, dh) i Ligjit 119/2014. Kjo fushë iu ofron qytetarëve informacion për ndarjen administrativo-territoriale, njësitë administrative përkatëse dhe nën-ndarjet e tyre, për misionin dhe funksionet e bashkisë, për organet e zgjedhura, për administratën e bashkisë, për statistikën vendore, për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit si dhe për të drejtën e kërkesës, ankesave dhe vërejtjeve të qytetarëve që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës së bashkisë.
- ➔ Fusha e dytë, e titulluar “Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare”, është nga fushat më kryesore të Programit dhe përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar nga neni 7 (pikat dh; e; ë) të Ligjit 119/2014. Këto kategori informacioni janë përshtatur me kërkesat e Ligjit Nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Në këtë fushë përfshihen informacione që kanë të bëjnë me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë, me programin buxhetor afatmesëm vendor, me

⁵⁶ Po aty, nenet 4, 5, 6, 7

⁵⁷ Programi model i Transparencës për njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri, është përgatitur nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim . Shih programin model https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/08/Programi_Model_i_Transparencës_pushteti_vendor.pdf

paketën fiskale (taksa dhe tarifa), me buxhetin vjetor, me zbatimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e buxhetit, me donacionet si dhe shitjen ose dhënien me qira të pronave dhe aseteve.

- ➔ Kërkesat për informim përbëjnë fushën e tretë, nëpërmjet të cilës vendosen në dispozicion të qytetarëve informacionet që kanë të bëjnë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim. Përmbledhja e katër kategorive të informacionit të përcaktuar në nenin 7 (pika c; ç; i; dhe k) të Ligjit nr. 119/2014 në një fushë të vetme lehtëson aksesin e qytetarëve për këto kategori informacioni, i orienton dhe udhëzon ato se si mund të bëjnë një kërkesë për informim si dhe u krijon mundësi qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit të vlerësojnë dhe monitorojnë në tërësi këto katër kategori informacioni.
- ➔ Një nga përgjegjësitë kryesore të bashkisë është ofrimi i shërbimeve publike duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballueshme nga të gjithë grupet e komunitetit. Në këtë kontekst, fusha e katërt “Shërbimet Publike” është për shërbimet që ofron bashkia dhe përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar në nenin 7 (pika: f; j, ë dhe pjesërisht pika a) të ligjit 119/2014. Nëpërmjet kësaj fushe vihet në dispozicion të qytetarëve informacioni për shërbime publike që ofron bashkia, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, strukturat përgjegjëse, procedurë e ankimimit në lidhje me kontratat publike, standardet, treguesit, procedurat për të përfituar shërbimet si dhe procedurat e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet.

➔ Fusha e pestë është legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore si kategori informacioni e përcaktuar në nenin 7, pika b të ligjit 119/2014. Kjo fushë u ofron qytetarëve informacion për legjislacionin, dokumentet politike dhe vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ të organeve të bashkisë. Për të lehtësuar qasjen në informacion, fusha e legjislacionit është ndarë sipas funksioneve për të cilat që bashkia është përgjegjëse me elementet përkatës për çdo fushë.

- ➔ Në hyrje të Kartës Evropiane për Autonominë Vendore përcaktohet se “e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike bën pjesë në parimet demokratike të përbashkëta”. Kjo e drejtë e qytetarëve mundësohet nga Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe në Program është paraqitur si fushë më vete dhe përfaqëson fushën e gjashtë të saj, e cila vendos në dispozicion të qytetarëve informacione në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare.
- ➔ Në fushën e shtatë bashkia vë në dispozicion të qytetarëve informacione të ndryshme, si proceset e integritit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime dhe vlerësime të ndryshme, veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës etj.; vetorganizimi komunitar.



5.4 Procesi i përgatitjes dhe zbatimit të Programit të Transparencës

Përgatitja

Procesi i përgatitjes së projekt-programit të transparencës drejtohet nga Kryetari i Bashkisë. Në këtë fazë merret parasysh Programi modeli i miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (i miratuar me Urdhrin Nr. 211, datë 10/09/2018), i cili është përshtatur me specifikat e njësive të vetëqeverisjes vendore me qëllim për të garantuar njohjen maksimale të qytetarëve me informacionin publik nga ana e bashkisë dhe vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion. Janë zhvilluar [...] takime konsultimi me aktorë të shoqërisë civile, medias, biznesit dhe qytetarë për të marrë mendime, sugjerime dhe rekomandime me qëllim që Programi i Transparencës të jetë sa më afër nevojave dhe preferencave të tyre.

Miratimi

Bazuar në nenin 9, 15 dhe 18/3 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 4 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe në modelin e miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (modeli i miratuar me Urdhrin Nr. 121, datë 10/09/2018, Këshilli Bashkiak me Vendimin Nr., datë...../..... ka miratuar Programin e Transparencës së bashkisë.

Publikimi

Brenda 10 ditëve nga data e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak, Programi i Transparencës publikohet (i) në faqen zyrtare të internetit të bashkisë (www.xxxxxxx.gov.al) në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” (linku) (ii) në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë [citohen adresat e vendeve].

Zbatimi

Kryetari i bashkisë është përgjegjës për zbatimin e përditshëm të Programit të Transparencës. Në ushtrim të kësaj përgjegjësie, Kryetari i bashkisë me Urdhër Nr..., datë..../...../201... ka caktuar [emër mbiemër], Koordinator për të drejtën e informimit si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Me Urdhër Nr..., datë..../...../201... ka caktuar [emër mbiemër], Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Me Urdhër Nr..., datë..../...../201.. ka miratuar Rregulloren e Administratës së bashkisë [linku] e cila në nenin ka përcaktuar procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të faqes zyrtare të internetit të bashkisë për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës. Në nenin janë përcaktuar procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo strukture të administratës për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës dhe në nenin janë përcaktuar procedurat e trajtimit të kërkesave për informim.

Monitorimi⁵⁸

Monitorimi është një fazë dhe proces mjaft i rëndësishëm i cili ka dy dimensione, atë të vlerësimit dhe të mbikëqyrjes nga institucionet publike dhe nga aktorët jo-publikë.

Monitorimi kryhet kryesisht nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili mbikëqyr respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe, në rastet kur vërehen mosrespektime të tyre, bën vlerësimin e kundërvajtjes dhe vendos gjobat administrative përkatëse. Çdo person, kur vlerëson se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Këshilli Bashkiak mbikëqyr informimin e publikut nga ana e bashkisë duke analizuar dhe vlerësuar shkallën e zbatimit të rregullave që ai vetë ka vendosur për këtë qëllim si edhe duke e kërkuar Kryetarin e Bashkisë në raport për këtë qëllim.

Kryetari i Bashkisë vlerëson dhe mbikëqyr të gjithë procesin e zbatimit të Programit të Transparencës nga ana e administratës së bashkisë, njësisve administrative dhe njësisve të varësisë. Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës do të bëhet jo më pak se njëherë në vit nga ana e këshillit dhe kryetarit të bashkisë nëpërmjet përdorimit të sistemit të matjes që shoqëron Programin model.

Ndër aktorët jo-publikë që gjithashtu monitorojnë zbatimin e Programit të Transparencës bëjnë pjesë organizatat e shoqërisë civile, media, biznesi, qytetarët dhe grupe të ndryshme. Monitorimi nga aktorët jo-publikë luan një rol thelbësor në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies si dhe në krijimin e besimit të qytetarëve. Çdo raport, studim, monitorim apo vlerësim për zbatimin e Programit të Transparencës nga ana e aktorëve jo-publikë sapo i vihet në dispozicion bashkisë publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë (www.xxxxxx.gov.al) në menunë /nën-menunë “Programi i Transparencës” [linku].

Shqyrtimi

Në bazë të pikës.....të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr....., datë...../...../201.. “Për miratimin e Programit të Transparencës” shqyrtimi i plotë i programit bëhet njëherë nëvjet. Shqyrtimi i Programit të Transparencës bëhet sipas të njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Programi do t’i nënshtrohet herë pas here rishikimeve të pjesshme për të përditësuar ndryshimet e reja ligjore e nënligjore me efekt në informimin publik.

- 6. Si informojnë bashkitë në Shqipëri?

Si informojnë bashkitë në Shqipëri?

Me qëllim garantimin e transparencës dhe informimin e publikut në lidhje me veprimtarinë e saj bashkia përdor kanale dhe platforma të ndryshme informimi, ndër të cilat faqja zyrtare e internetit është parësore. Megjithatë, nuk mjafton vetëm të publikosh informacione në faqen e internetit të bashkive. Këto të fundit duhet të angazhohen për të ndërmarrë hapa konkrete dhe praktike për ndërgjegjësimin apo edukimin e qytetarëve për të aksesuar informacionin publik, duke përdorur një sërë kanalesh informimi që kanë si qëllim edhe qytetarët më të marginalizuar apo ata që jetojnë në zona më të largëta. Disa nga kanalet e informimit që bashkitë përdorin janë:

Faqja zyrtare: Faqja zyrtare në internet është një instrument parësor që përdoret nga bashkitë për të informuar qytetarët.

Rrjetet sociale si “Facebook” janë mjete shumë të rëndësishme për shpërndarjen e informacionit, pasi në këto faqe jo vetëm që mund të matin shikueshmërinë e lajmit apo informacionit, por marrin dhe reagimet e komunitetit nëpërmjet numrit të pëlqimeve dhe komenteve konkrete për çdo postim. Elementi kryesor është ndërveprimi (interaktiviteti) që ofrohet nga mediat sociale dhe që nuk mund të ofrohet nga faqet zyrtare në internet.

Media vizive: Bashkitë përdorin mediat lokale me qëllim njoftimin dhe informimin e qytetarëve për takimet me komunitetin, për shpërndarjen e informacionit lidhur me dëgjesat publike, mbledhjet e këshillit bashkiak etj. apo çdo informacioni të nevojshëm. Kjo mënyre u krijon mundësi informimi qytetarëve që edhe pse kanë interes për të marrë pjesë në mbledhjet që realizon bashkia, e kanë të pamundur praninë fizike në këto aktivitete.

– Bashkia Tiranë dhe Shkodër transmetojnë në lidhje të drejtpërdrejta mbledhjet e këshillit bashkiak si një mënyrë e zgjedhur për përfshirjen e komunitetit.

Zyrat me një ndalesë janë një mjet efektiv për marrjen e informacionit të kërkuar, pasi shërbimet janë të qendëruara për qytetarët. Këto zyra mundësojnë përmirësimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve administrative nga qeveria vendore, duke reduktuar ndjeshëm kohën, distancat dhe burokracitë me të cilat duhet të përballen qytetarët. Gjithashtu, ato u ofrojnë vendimmarrësve të dhëna mbi performancën, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.

Portalet informative

Portali “Open Data Tirana” (<http://opendata.tirana.al/>) është një platformë elektronike me të dhëna statistikore për bashkinë në format të lexueshëm dhe pa kufizim licence (open data) dhe lehtësisht të analizueshme.

Portale të tjerë informativë: Porta Vendore, e-Albania, vendime.al, etj.

Këndi Informativ ofron informacion kryesisht për ata qytetarë të cilët nuk mundin të përdorin teknologjinë apo nuk kanë akses në mjete të tilla teknologjike. Këndi Informativ është një vend me mundësi aksesit nga i gjithë komuniteti, zakonisht i vendosur pranë ambienteve të njësisë administrative. Në këtë kënd afishohen jo vetëm njoftimet më të fundit, por edhe njoftimet për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit bashkiak apo edhe informacione për Programin e Transparencës.

Media e shkruar, gazetat apo revistat janë forma të tjera që përdoren shpesh nga bashkitë për të informuar publikun. Kjo mënyrë u vjen në ndihmë qytetarëve të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të vihen në dijeni për takimet dhe vendimet e marra nga këshilli bashkiak apo nuk mund të jenë të pranishëm në sallën e mbledhjeve.

- ➔ Bashkia Elbasan aplikon praktikën e botimit të një gazete të përjavshme pa pagesë, që shërben për informimin e qytetarëve lidhur me zhvillimet e javës apo njoftimet e rëndësishme, informimin mbi takimet me komunitetin dhe dëgjuesat publike, etj. Kjo gazetë ka rubrika të ndryshme që informojnë qytetarët për punën e kryer nga administrata vendore.
- ➔ Në Bashkinë e Korçës botohet një revistë vendore çdo 2 muaj për të informuar qytetarët për vendimet e marra nga pushteti vendor, politikat si dhe përmbledhje të projekteve sociale, aktivitetet social-kulturore të organizuara nga bashkia.

Mjete të tjera të përdorura për informimin e qytetarëve:

- ➔ Deklaratat për shtyp dhe e-mailet për pikat e kontaktit që disponojnë.
- ➔ Numër i dedikuar telefoni për të ofruar informacione dhe ndihmë për qytetarët.
Në Bashkinë e Tiranës shërbimi me qytetarët mundësohet çdo ditë në orarin 08:30 - 22:00, duke shmangur në këtë mënyrë nevojën për t'u paraqitur fizikisht në sportel.
- ➔ **Aplikacione**
 - **Aplikacioni ‘Përmirëso qytetin tënd’** është vendosur në funksion të gjithë qytetarëve shqiptarë për të raportuar probleme të ndryshme në qytetet e tyre.
 - **Aplikacioni “Tirana ime”** ku qytetarët krahas kërkesave dhe ankesave për shërbimet e lartpërmendura, mund të gjejnë informacione për trafikun, transportin, mundësitë e parkimit, listën

-
- 7. Ushtrime dhe raste studimore:

7

USHTRIME DHE RASTE STUDIMORE

Ushtrim 1. Si të formulojmë një kërkesë dhe ankesë në lidhje me të drejtën e informimit.

Të gjithë pjesëmarrësve u jepet një format tip kërkesë dhe ftohen ta plotësojnë. Fillimisht pjesëmarrësit instruktohen se si mund të bëjnë një kërkesë për një informacion që mund të jetë i rëndësishëm për ta. Plotësojnë kërkesën dhe më pas trajnesi apo vetë pjesëmarrësit lexojnë kërkesat. Diskutohet në grup nëse kërkesa ka qenë sipas standardeve të kërkuara dhe nëse ka plotësuar të gjitha kushtet.

Në pjesën e dytë të ushtrimit, pjesëmarrësve u jepet një format tip anekse. Pjesëmarrësit ftohen të bëjnë një ankesë ndaj një institucioni publik duke shpjeguar edhe arsyet. Më pas, aneksa lexohet dhe diskutohet në grup nëse qytetari ka plotësuar të gjitha detyrimet ligjore.

Ushtrim 2. Si informojnë bashkitë?

Pjesëmarrësit ndahen në grupe me nga 4-5 individë në secilin grup. Secili grup ftohet të përzgjedhë në mënyrë rastësore 5 bashki. Pjesëmarrësit duhet të identifikojnë format e informimit të bashkisë dhe t'i diskutojnë me njëri-tjetrin, duke reflektuar mbi disa pyetje:

- A mendoni që mjetet e informimit janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e të gjitha grupeve në komunitet?
- A mendoni që informacioni i ofruar publikisht është në përputhje me standardet ligjore?
- A është publikuar informacioni në Programin e Transparencës?
- A janë bërë publike të dhënat e Koordinatorit për të drejtën e informimit?
- A është publik regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve?
- A janë plotësuar me informacion të plotë rubrikat në Programin e Transparencës?

Rast Studimor Nr. 2

Një organizatë jo qeveritare, X, me anë të një shkrese zyrtare kërkon nga Ministria Y informacion lidhur me:

- Një kopje të kontratës së koncesionit për HEC dhe të marrëveshjes(ve) shtesë apo marrëveshjes(ve) për ndryshimin e kësaj kontrate.
- Kopje të dosjes së plotë të dokumentacionit, duke përfshirë të gjithë praktikën e procedurës konkurruese deri tek nënshkrimi i kontratës së koncesionit.

Pyetje:

1. A është informacioni i kërkuar informacion publik?
2. A duhet refuzuar dhënia e këtij informacioni?
3. Çfarë duhet të bëjë organizata “x” pas refuzimit dhënies së informacionit?

Vendimi i Komisionerit:

Pas refuzimit të dhënies së informacionit me argumentin e konfidencialitetit, organizata “x” kërkoj nga zyra e Komisionerit urdhërimin e autoritetit publik për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar. Komisioneri ushtroi inspektim pranë AP duke i kërkuar parashtrime të bazuara në ligj lidhur me këtë refuzim. Përveç këtij termi të vendosur në kontratat e koncesioneve, refuzimi nuk bazohet në ndonjë evidencë tjetër. Prandaj Komisioneri vlerësoi se lidhur me këtë rast, kufizimet e paraqitura në Ligjin “Për koncesionet” nuk prekin në tërësi informacionin e kërkuar. Gjithashtu, neni 17 i Ligjit 119/2014, i cili parashikon kufizimet e dhënies së informacioneve, në pikën 6-të të tij përcakton se nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit siç janë të dhënat teknike, pjesa tjetër i vihet në dispozicion kërkuarit.

Rast Studimor Nr. 3

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit i ka prishur pronën qytetarit X.Y dhe nuk i ka dhënë asnjë vendim apo shkresë për këtë veprim. Qytetari X.Y ka dërguar një kërkesë për informacion pranë këtij institucioni, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ai u paraqit edhe një herë para sportelit të institucionit, pas kalimit të afatit 10 ditor dhe aty iu tha se nëpunësit janë shumë të zënë me punë në terren dhe nuk kanë pasur kohë për të shqyrtuar kërkesën e tij.

Pyetje:

1. Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëjë qytetari?
2. A duhet të vazhdojë të presë?
3. Çfarë duhet të bënte sportelisi, nëpunës publik? A duhet ta orientonte qytetarin X.Y për hapat e mëtejshëm?
4. Çfarë detyrimi ka Inspektorati në rastin konkret?
5. Nëse ankohet tek KDIMDP, çfarë hapash mund të ndërmarrë kjo zyrë?

Rast Studimor Nr. 4

Studenti A.Z. është duke punuar mbi një detyrë kursi dhe i nevojitet një vendim i Këshillit të Ministrave, i cili nuk është botuar ende në Fletore Zyrtare. Studenti plotëson një formular kërkesë dhe e depoziton atë pranë Këshillit të Ministrave. Nëpunësi X, staf i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, i cili ka kompetencën e shqyrtimit të kësaj kërkesë, nuk është i sigurt nëse ky dokumentacion është i tillë që mund të vihet në dispozicion të qytetarit.

Pyetje:

1. Çfarë do të bëni, nëse jeni nëpunësi përgjegjës për dhënien e informacionit?
2. Si do t'i përgjigjeni studentit?
3. A duhet që të pyetet drejtori, ose të refuzohet dhënia e dokumentacionit, ose që të njoftohet kërkuesi që do të studiohet ligji dhe përgjigja të jepet më vonë?





Rast Studimor Nr. 5

Një OJQ me fokus dhe objekt të veprimtarisë mbrojtjen e mjedisit iu drejtua Ministrisë së Mjedisit duke kërkuar informacion lidhur me një studim lidhur me riskun mjedisor në fabrikën e demontimit të armëve në Gërdec. Ministria e Mjedisit ktheu përgjigje brenda 10 ditë pune duke refuzuar dhënien e dokumentacionit me argumentin se informacioni i kërkuar ishte objekt i kufizimeve, konkretisht të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve (sekreti industrial, siguria kombëtare (rreziku i akteve terroriste) dhe shëndeti publik). Por organizata joqeveritare nuk u mjaftua me përgjigjen e dhënë dhe u ankua pranë zyrës së Komisionerit.

Pyetje:

1. Çfarë duhet të bëjë autoriteti publik? Duhet ta vërë në dispozicion informacionin e kërkuar apo jo?
2. Çfarë duhet të bëjë zyra e Komisionerit në këtë rast?

E DREJTA PER INFORMIM

 /company/idm-albania  <http://www.idmalbania.org/>  /idm_albania  /IDMALbania

Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1, 1017, Tirana | T +355 4 240 0241 | info@idmalbania.org